

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 12-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuele**  
**mbajtur më 28.3.2023**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional:** Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr. Magdalena Davidovska Dogleva, Dimitar Tanurov, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë : /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në orën 14:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati 2-të.

Z. Petrushevski shpjegoi se propozimin e Rendit të ditës gjatë leximit do ta plotësojë me një pikë tjetër - Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv për SHTR TELEVISION PLUS SHPK Kumanovë, si Pika 7, e cila me e-mail u është njoftuar anëtarëve të Këshillit gjatë ditës së djeshme.

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri ndryshimin e mëposhtëm:

**RENDI I DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 2-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 21.3.2023.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 11-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 21.3.2023.
3. Propozim-raport vjetor për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022.
4. Propozim-qëndrim i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele lidhur me rezultatin e revizionit të kryer nga revizor i pavarur për vitin 2022.
5. Propozim për anulimin e Vendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike.
6. Propozim për dhënie miratimi për zbatimin e procedurës së furnizimit publik - mallra: Produkte higjienike.
7. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv për SHTR TELEVISION PLUS SHPK Kumanovë.

8. Të ndryshme.

#### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin nga seanca e 2-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 21.3. 2023 , me tekstin e propozuar.

#### **Pika 2**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin nga seanca e 11-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 21.3.2023, me tekstin e propozuar.

#### **Pika 3**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim- Raportin vjetor për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022. Ai shpjegoi se në seancën e mbajtur një javë më parë, dokumenti i propozuar është shqyrtuar në formë drafti dhe meqenëse nuk ka pasur vërejtje dhe sugjerime lidhur me përmbajtjen, është dorëzuar si draft dokument. Raporti përfshin Raportin për zbatimin e Planit vjetor për mbikëqyrjen e programit për vitin 2022 dhe Raport financiar për zbatimin e Planit financiar për vitin 2022, llogarinë vjetore me të hyrat e realizuara, shpenzimet, kërkesat dhe detyrimet për vitin 2022, Raportin e revizionit (auditimit) nga revizor i pavarur për vitin 2022 dhe Qëndrimi i Agjencisë, i cili do të shqyrtohet si pikë e radhës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për miratimin e Raportit vjetor për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022 (me Raport për zbatimin e Planit vjetor për mbikëqyrjen e programit për vitin 2022 dhe Raportin financiar për zbatimin e Planit financiar për vitin 2022 dhe llogarinë vjetore me të hyrat e realizuara, shpenzimet, kërkesat dhe detyrimet për vitin 2022), me tekstin e propozuar.

Agjencia duhet të veprojë në pajtim me nenin 8 paragrafi 2 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/ 14, 142/ 16, 132/17, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20 dhe 77/21) dhe neni 11 paragrafi (2) i Rregullores për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.7.2019.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli të publikon vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

#### **Pika 4**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-qëndrimin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele lidhur me rezultatin e revizionit (auditimit) të kryer nga revizor i pavarur për vitin 2022. Ai ka shpjeguar se pas revizionit të kryer nga revizor i pavarur, Raporti i tyre është

dorëzuar në Agjenci. Në të ka rezervë për dy raportet, njëra prej të cilave është diametralisht e kundërt me pretendimet e Entit Shtetëror për revizion dhe pas veprimeve të rekomanduara nga Enti Shtetëror i Revizionit, dhe ka të bëjë me tokën nën objektin afarist të Agjencisë. Ai ka thënë se në atë drejtim ka pasur edhe një takim joformal me revizorin shtetëror, i cili mbetet në qëndrimin e tij që e kanë dhënë në Raportin nga Enti Shtetëror i Revizionit. Në të kundërt, revizori i pavarur ka një qëndrim krejtësisht diametralisht të kundërt në lidhje me tokën nën objekt. Vërejtja e dytë e revizorit (auditorit) të pavarur është se me 31 dhjetor 2022 Agjencia ka pretendime (të arkëtueshme) prej 2 milionë e 880 mijë denarë më të vjetra se një vit. Kjo vërejtje ka qenë edhe në Raportin e disa viteve më parë kur është bërë auditimi nga revizor i pavarur dhe ku është kërkuar që këto pretendime të fshihen.

Z. Petrushevski sqaroi se propozimi i drejtorit është që të caktohet pozita ashtu siç është në materiale, që të pajtohen me revizorin e pavarur.

Z. Trajçev tha se është pak i hutuar sepse nga njëra anë drejtori tha se ka kontradiktë mes deklaratave të Entit Shtetëror të Revizionit dhe revizorit të pavarur, dhe nga ana tjetër ka propozim që duhet të pajtohen. Pyetja e tij është nëse duhet të pajtohen me Raportin e Entit Shtetëror të Revizionit apo me Raportin e revizorit të pavarur. Cili është qëndrimi i tyre ndaj tij është paksa i paqartë, para së gjithash sepse ai tani ka marrë informacionin se ka dallime në të dy raportet. Ai kërkoi një shpjegim për të mos gabuar kur të marrë vendim. Lidhur me pretendimet, ai pyeti nëse Agjencia ka marrë masa dhe procedura në lidhje me pretendimet?

Lidhur me pretendimet, z. Trajçevski sqaroi se janë marrë të gjitha masat. Procedura për një kërkesë ka përfunduar dhe meqenëse debitori nuk ka pasuri tjetër, Agjencia po i heq 30% të pensionit që merr, kjo do të zgjasë për shumë vite, por nuk ka rrugë tjetër në këtë moment për ta kthyer këtë borxh. Sa i përket Entit Shtetëror për revizion, ai ka bërë revizion në vitin 2021 për vitin 2020. Një nga rekomandimet ishte toka nën objektin e Agjencisë të përfshihet në bilanci të Agjencisë. Ka qenë rekomandim dhe Agjencia ka vepruar sipas atij rekomandimi. Tani qëndrimi i revizorit të pavarur është i kundërta. Në një bisedë me revizorin e pavarur, ata i kanë shpjeguar se toka nën objekt nuk mund të vihet në qarkullim me pagesë, sepse kush do të blejë tokë në të cilën tashmë është ndërtuar një objekt. Sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, ai mendon se kjo është në kundërshtim me qëndrimin e Revizionit Shtetëror, por si Revizori Shtetëror ashtu edhe ai i pavarur kanë leje të marrë nga shteti. Në vendet e tjera të BE-së ekziston mundësia që pronari i tokës të kompensojë pronarët e bashkëpronësisë mbi tokën dhe t'i dëbojë në një vend të përshtatshëm ose t'u paguajë kompensim për këtë, nëse kjo shihet nga standardet ndërkombëtare. Për shembull, në Greqi dhe Bullgari nuk blihet toka, por pronësia e banesës dhe nëse pronari i tokës vendos, mund t'i dëbojë, t'u japë një apartament të përshtatshëm ose para, sepse ka vendosur të ndërtojë p.sh. një ndërtesë. Tani në rastin tonë ka dy qëndrime kontradiktore të Entit Shtetëror të revizionit dhe revizorit të pavarur. Revizori shtetëror fillimisht paraqet Draft-raport të cilit Agjencia mund t'i paraqesë vërejtje, pastaj ato vërejtje shqyrtohen nga Enti Shtetëror për revizion dhe dorëzohet një dokument përfundimtar. Ndryshe është me revizorin e pavarur, ai dorëzon një dokument përfundimtar dhe lind pyetja çka nëse Agjencia nuk e pranon.

Z. Petrushevski iu drejtua drejtorit për atë që tha se Enti Shtetëror i Revizionit këtë mendim e ka formuar në vitin 2021 për vitin 2020, ndërsa revizori i pavarur e ka dhënë mendimin në vitin 2023 për vitin 2022, dhe ka pyetur pse tani pas dy vitesh revizori i pavarur jep mendim për opinionin e Entit Shtetëror të Revizionit?

Z. Trajçevski sqaroi se revizori i pavarur nuk jep mendim për opinionin e Entit Shtetëror për Revizion. Gjatë kryerjes së revizionit ai kërkon të dhënat për funksionimin e ASHMA-së.

Në llogaritë përfundimtare janë ato të dhëna dhe është vepruar siç ka thënë Revizioni Shtetëror. Ai i sheh ato të dhëna automatikisht. Dhe kështu nuk është vetëm tek ASHMA-ja, por një mendim të tillë e ka dhënë edhe te AKE-ja. Ai sqaroi se ASHMA-ja nuk do të veprojë sipas mendimit të revizorit të pavarur sepse Agjencia tashmë ka vepruar sipas mendimit të Entit Shtetëror të Revizionit. Edhe nëse Këshilli dhe Agjencia nuk pajtohen me Raportin, ai nuk mund të ndryshohet, mbetet fakt.

Udhëheqësi i Sektorit të Financave dhe Logjistikës, Goran Radunović, ka shpjeguar se në të gjitha institucionet shtetërore, kur Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizionin atë vit, të gjitha institucioneve u është rekomanduar që në bilancet e tyre të përfshijnë tokën në ndërtesë. Qëndrimi i revizorit të pavarur është se kjo tokë do të ketë vlerë vetëm nëse ndërtesa shembet nga një tërmet dhe atëherë pronari i tokës do të jetë në gjendje ta tregtojë këtë tokë. Deri në atë moment trualli është pjesë përbërëse e objektit. Kur për shembull, ndërtesa shitet, nuk mund të jepet një çmim veçmas për ndërtesën dhe veçmas për tokën në ndërtesë, por duhet vendosur një çmim. Në atë kuptim nuk pajtohen dhe ka sqaruar se nëse toka nuk është nën objekt, pra është oborr dhe nëse në atë tokë ndërtohet një objekt shtesë, atëherë ajo tokë do të ketë vlerë.

Z. Fidanoski vuri në dukje dy momente. Meqenëse tashmë është hapur një diskutim, sipas njohurive të tij laike për këtë çështje, kur një person shet një ndërtesë me oborr, oborri është hapësira totale në të cilën ndodhet hapësira nën objekt dhe shitet së bashku tërësisht, me objektin që ka kvadraturë tjetër, pra shkon në shitje dhe jo se nuk mund të shitet toka në ndërtesë. Momenti i dytë është se Agjencia ka objekt që përmban edhe garazh nëntokësor që është pjesë e objektit dhe po përdoret, çfarë bëhet në atë rast? Ai shpjegoi se fillimisht kishte dilemë nëse opcioni i revizorit të pavarur është i saktë, nuk pretendonte se është në të drejtë, por kishte rezervë në konstatimin e tij.

Z. Trajçev tha se ajo që tregoi z. Fidanovski nga çështja juridike mund të shihet ndryshe, si e drejtë për shfrytëzim, e drejtë pronësie dhe të ngjajshme, ka mënyra të ndryshme si mund apo nuk mund të transformohet, por këtu është çështje financiare, pra një çështje kontabiliteti, nëse duhet të regjistrohet apo jo. Në atë pjesë të pyetjes financiare ai tha se nuk e konsideron veten mjaft ekspert për të vendosur se çfarë është e drejtë dhe si të veprojë. Propozimi në materiale është që të jepet mendim se pajtohen me Raportin e Revizionit të Pavarur në tërësi. Tani ai është pak i hutuar dhe nuk e di nëse duhet të pajtohet sepse një organ shtetëror thotë se duhet të jetë një mënyrë, dhe nga ana tjetër është një kompani e pavarur revizioni që thotë se duhet të jetë ndryshe. Ka një propozim që Këshilli duhet të pajtohet me opinionin e firmës (kompanis) së pavarur të revizionit dhe jo me Revizionin shtetëror. Prandaj ai është në dilemë dhe meqë propozimi është i tillë, tha se nuk mund të votojë, nuk ka qëndrim se si të voton.

Z. Petrushevski tha se ka dy propozime. E para është të pranohet mendimi i revizionit të pavarur por jo në tërësi, pra të ndahet pjesa në lidhje me tokën ku nuk pajtohen. Propozimi i dytë është shtyrja e pikës.

Z. Trajçevski tha se nuk ka mundësi për shtyrje të pikës sepse Raporti vjetor duhet të përgatitet dhe të dorëzohet në Kuvend jo më vonë se 31 mars 2023.

Z. Fidanoski tha se pajtohet me propozimin e parë të z. Petrushevski. Për të është e pranueshme dhe mendon se një qëndrim i tillë duhet të ketë dhe Këshilli, me formulimin se pranojnë Raportin e revizorit të pavarur përveç pjesës për truallin në ndërtesë.

Z. Trajçev tha se drejtimi është në rregull, por nga ana tjetër nuk mund të thonë se nuk pajtohen, ndoshta kanë të drejtë, nuk janë ekspert të mjaftueshëm në atë fushë për të thënë nëse është ashtu apo jo ashtu. Ai sugjeroi që nëse bëhet ndonjë formulim, nuk duhet të thuhet se pajtohen, kjo nuk rrjedh nga Ligji, mund ta pranojnë Raportin dhe mund të thuhet se Këshilli ka rezervë në pjesën e Pikës 9 të Raportit kur ka kontradiktë me mendimin Entit shtetëror për revizion dhe me revizorin e pavarur. Përndryshe formulimi "pajtohem" nuk duhet të jetë aty sepse ata nuk pajtohen.

Z. Petrushevski tha se formulimi "pajtohem" mund të zëvendësohet me "pranon..." përveç në atë pjesë ku Këshilli ka rezervë sepse mund të kenë të drejtë ose jo.

Z. Petrushevski me sugjerim të z.Fidanoski, propozoi që të bëhet një pushim i shkurtër për konsultime të mëtutjeshme.

Pas një pauze të shkurtër, z. Petrushevski e vazhdoi seancën. Ai shpjegoi se në bazë të diskutimeve të mëparshme të anëtarëve të Këshillit, Drejtorit të Agjencisë dhe punonjësve të Shërbimit Profesional, propozimi është që të ndryshohet Propozim-qëndrimi i Agjencisë me këto fjalë: Agjencia e pranon mendimin e dhënë në Raporti e revizionit për vitin 2022 i vërtetuar në arkivin e Agjencisë me nr.02-1149/2 datë 23.3.2023 me rezervë lidhur me mendimin me rezervë të revizorit të pavarur për truallin (tokën) nën objektin e Agjencisë.

Ky propozim u pranua njëzëri (unanimisht).

## **Pika 5**

Z. Trajçevski shpjegoi propozimin për anulimin e Vendimit për shqiptimin e masës vërejtje publik . Ai shpjegoi se në njërin nga seancat paraprake i është shqiptuar vërejtje publike operatorit KABEL-NET SHPK Strumicë, për shkak të ritransmetimit të shërbimit programor "Euronews Bulgaria" i cila nuk mbulohej me çertifikatë për regjistrimin e shërbimeve programore të dhëna nga Agjencia. Pas masës së miratuar për vërejtje publike, Agjencia u informua nga operatori se Euronews Bulgaria është emri i ri i Televizionit Evropa pas riemërtimit. Ky nuk është një shërbim i ri programor për të cilin nuk ka rregullore për të drejtat e autorit. Operatori për këtë ka dërguar Shkresë dhe logo të re në mënyrë që sistemi të identifikonte kanalën e riemërtuar. Ai bën me dije se ndërkohë ka pasur një bisedë telefonike me pronarin e operatorit, i cili ndërkohë ka fikur kanalën. Për të mundësuar ritransmetim në të ardhmen, është e nevojshme të anulohet Vendimi për vërejtje publike të miratuar nga Këshilli. Ai theksoi se Sektori për planifikim strategjik dhe mbrojtje të së drejtës së autorit ka përgatitur Raport të korigjuar me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit, ku thuhet se nuk ka pasur shkelje gjatë mbikëqyrjes së programit.

Z. Trajçev, në lidhje me formulimin në Propozim-Vendim ku thuhet "shpallet i pavlefshëm", tha se duhet të shkruhet "Anulohet".

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, sqaroi se kur akti administrativ anulohet dhe shpallet i pavlefshëm, efekti është i njëjtë, anulohet edhe akti administrativ dhe pasojat në vazhdim. Ajo ka deklaruar se ka pranuar propozimin për të vendosur "anuluar".

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për anulimin dhe shpalljen e pavlefshme në tërësi të Vendimit për paralajmërimin publik dhe përjashtimin e ritransmetimit të shërbimit programor Up1 nr.11-115 datë 14.3.2023 .

Sektorit për planifikim strategjik dhe mbrojtje të të drejtave të autorit ka përpiluar Raport me shkrim të korrigjuar për mbikëqyrjen e kryer të programit nr. 11-1091/3 datë 23.3.2023 të operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KABEL-NET SHPK Strumicë, nga ku u konstatua se gjatë mbikëqyrjes së programit nuk janë konstatuar shkelje.

Sektorit për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

### **Pika 6**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik Cvetanka Mitrevska, ka shpjeguar propozimin për dhënie të miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – mallra: mjete higjienike . Shpjegoi se është furnizim i rregullt që kryhet në mënyrë të vazhdueshme. Sipas shumës së mjeteve do të realizohet si furnizim me vlerë të ulët dhe kontrata që do të rezultojë do të lidhet për një periudhë 2-vjeçare. Pjesa tjetër e të dhënave mund të gjendet në materialet e dorëzuara sipas pikës.

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri zbatimin e procedurës për furnizim publik-mallra: Mjete higjienike, për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën (artikullin)-mallra: Mjete higjienike është paraparë dhe është në pajtueshmëri me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4766/1 datë 23.12.2022, dhe mjetet sigurohen nga Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, pra do të sigurohen më tej nga Plani financiar i Agjencisë për vitin 2024.

### **Pika 7**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv për SHTR TELEVISION PLUS SHPK Kumanovë . Ai ka shpjeguar se ky transmetues ka paguar pjesën më të madhe të shumës së faturës së dorëzuar, gjegjësisht ka paguar 148.365,00 denarë dhe duhet të paguajë edhe 10.000,00 denarë të tjera. Për këtë arsye, meqenëse kanë kaluar të gjitha afatet ligjore, propozohet që të inicohet procedurë për heqjen e lejes, me shpresë se në 15 ditët e ardhshme do të paguajë të gjithë shumën.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka nisur procedurën për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TELEVISION PLUS SHPK Kumanovë, nr. 08-626, datë 18.3.2015, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16 , 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27 /19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 42/20 dhe 77/21).

Sipas Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr. 05-1377/1 datë 24.3.2023, transmetuesi nuk e ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar tarifën vjetore për lejen e transmetimit televiziv të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan tarifën vjetore të lejes në përputhje me faturën e dhënë (lëshuar) nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15

(pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miraton Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv ndaj SHTR TELEVISION PLUS SHPK Kumanovë, nr.08-626 nga 18.3.2015 .

**Pika 8**

**Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Nr. 02-1364/7**

**10.04.2023**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike**

**Audio dhe Audiovizuele**

**Kryetari i Këshillit,**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**